

DPK PKPP 06



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPK/E-D	Nr. Prot. Br.Prot. 01-883/15
Nr. I taq. 03	Data Datum 26.03.2015
PRISHTINE	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	16.03.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Avni GASHI Drejtor i Departamentit të Prokurimit në Kompaninë e Ujësjetllësit Rajonal Prishtina
CC:	z. Gjelo Vataj Kryeshef Ekzekutiv në Kompaninë e Ujësjetllësit Rajonal Prishtina
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull "Sigurimi fizik i objekteve të KURP Sh.A."



*Inderuari z. Gashi,*

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me "Sigurimi fizik i objekteve të KURP Sh.A." me numër prokurimi: KURP 15 001 221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me Tenderin Publik "Sigurimi fizik i objekteve të KURP Sh.A." me numër prokurimi: KURP 15 001 221, në mënyrë që të procedohet në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/42 për Prokurimin Publik.

### *Arsyetime*

Agjencia kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare njofton Autoritetin Kontraktues KURP se do të jetë pjesë e vëzhgimit në ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave për aktivitetin e Prokurimit.

Më datë 30.01.2015 përfaqësuesi i AKK-së ka qenë pjesë e vëzhgimit në vlerësimin e tenderit në fjalë. Gjatë monitorimit të këtij procesi të prokurimit, komisioni vlerësues ka konstatuar se të gjithë OE që kanë tenderuar për këtë kontratë janë të përgjegjshme duke plotësuar të gjitha kërkesat e kërkuara sipas Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë.

Komisioni vlerësues ka rekomanduar që të shpërblehet me kontratë Operatori ekonomik ROSA SECURITY i cili i plotëson të gjitha kërkesat e caktuara në dosjen e tenderit dhe ka ofertuar me çmimin më të ulët. Mirëpo, edhe pse me çmim më të ulët vlera e kësaj oferte e tejkalon vlerën e parashikuar të kontratës për 8,285.90€.

Pas kësaj AKK kontaktoi përmes telefonit zyrtarin nga Autoritetin Kontraktues KURP lidhur me procedurat e ndërmarra për pjesën e vlerës së ofertës e cila tejkalon vlerën e parashikuar të kontratës, zyrtari nga AK-KURP ndër të tjera theksoi se për këtë çështje do ta konsultojnë menaxherin e financave dhe për hapat në vazhdim do ta informojnë Agjencinë.

Më datë 10.02.2015 Autoriteti Kontraktues KURP përmes postës elektronike i dërgon AKK-së Raportin final të vlerësimit për tenderin në fjalë, Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimit e Diponueshmerisë së fondeve (DNPDP) të ri-aprovuar. Po ashtu në këtë emaili AK-KURP ka sqaruar se buxheti i paraparë për një vit fiskal ka qene 60,000.00 euro, ndërsa në kemi pranuar ofertat me çmimin me të lire, ku ka patur shumën prej 68,285.95€ për dy vite. Pikërisht për këtë kemi pasur bazën të dërgojmë tek OE një Letër Standarde të kërkesës për informata për Tenderët jo normalisht të ulet. Kemi pranuar përgjigjen ku mund të shihen konfirmimet dhe kalkulimet e OE që dëshmojnë se me këtë fond mund të mbulohen pagat minimale, sipas ligjeve të Kosovës. Pas pranimin të këtij emaili AKK kontaktoi përmes telefonit përsëri zyrtarin nga AK-KURP lidhur me veprimet e ndërmarra për shumën e cila tejkalon vlerën e parashikuar të kontratës, zyrtari nga AK theksoi se me që kontrata është publike kornize për dy vite dhe DNPDP është për një vite ku vlera e saj është 60,000.00€ në do të vazhdojmë me procedurat pasi që vitin e ardhshëm fiskal në do ta plotësojmë edhe pjesën për 8,285.95€. Më datë 20.02.2015 AK- KURP publikoi në faqen elektronike të KRPP-se njoftimin për dhënie të kontratës, ku emri i OE i cili është shpërblyer me kontratë është ROSA SECURITY në vlerë prej 68,285.95€.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar dhe ekzaminuar me kujdes dokumentacionin e ofruar lidhur me këtë procedurë të prokurimit dhe pas monitorimit që ka bërë në vlerësimin e

këtij tenderi nuk ka gjetur prova të mjaftueshme me të cilat do të evidentohet ndonjë shkelje e dispozitave të LPP-së.

**Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr.03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.**

Me respekt !

